

Prefekti i Qarkut

Prefekti i Qarkut në mbështetje të ligjit 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” emërohet dhe shkarkohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.

Përgjegjësitë kryesore të Prefekti në mbështetje të nenit 8 të ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” janë:

- a) verifikimin e ligjshmërisë së vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore;
- b) bashkërendimin e veprimtarisë ndërmjet degëve territoriale, që veprojnë në qark si dhe të këtyre degëve me organet e njësisë të vetëqeverisjes vendore;
- c) raportimin periodik në Këshillin e Ministrave për veprimtarinë e degëve territoriale që veprojnë në qark, sipas urdhrit të Kryeministrit, dhe, për probleme të veçanta, sipas urdhrit të ministrit;
- ç) informimin çdo gjashtë muaj të institucioneve qendrore për veprimtarinë e strukturave të tyre të varësisë, në nivel qarku;
- d) nxitjen dhe zhvillimin e marrëdhënieve e të veprimtarive me institucionet homologe sipas marrëveshjeve përkatëse;
- dh) drejtimin e strukturave për parandalimin, menaxhimin, rehabilitimin e pasojave në rastet e emergjencave civile;
- e) drejtimin e task-forcave, krijimin e organizmave të përkohshëm, të komiteteve, të grupeve të punës dhe të komisioneve për çështje të caktuara;
- ë) drejtimin ose pjesëmarrjen në ceremonitë zyrtare shtetërore që zhvillohen në nivel qarku, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- f) forcimin e kapaciteteve institucionale në zbatim të programeve të buxhetit të shtetit;
- g) kontrollin dhe monitorimin e zbatimit, në nivel qarku, të politikave sektoriale të Këshillit të Ministrave në bujqësi, arsim, shëndetësi, mjedis, rend publik, shërbim zjarrfikës, ndihmë dhe përkrahje sociale, turizëm dhe kulturë;
- gj) bashkërendimin e veprimtarisë së tij me agjencitë dhe inspektoratet që veprojnë në nivel qarku, si dhe monitorimin e veprimtarisë së tyre. Për mosmarrëveshjet që mund të lindin me drejtuesit e këtyre institucioneve, prefekti i drejtohet ministrit përgjegjës;
- h) shqyrtimin çdo muaj të veprimtarisë së degëve territoriale që veprojnë në qark dhe bashkërendimin e punës ndërmjet tyre dhe organeve të vetëqeverisjes vendore, në zbatim të programit të Këshillit të Ministrave;
- i) bashkërendimin e punës me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve dhe struktura të tjera zgjedhore vendore, në përputhje me parashikimet e Kodit Zgjedhor;
- j) ushtrimin e përgjegjësisë dhe detyrave të tjera që i ngarkohen me akte ligjore ose nënligjore.

Niveli i pagës sipas pikës 6 të VKM-së nr. 187 datë 8.3. 2017 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit” e ndryshuar.

Prefekti Elbasan

Z. Ilir Bejtja u lind më datë 17 Janar 1966, në qytetin e Elbasanit. Z. Bejtja është me profesion ekonomist, i diplomuar me titullin Ekonomist Industrie në Universitetin e Tiranës, Fakulteti Ekonomik në vitin 1988. Ka mbaruar studimet master, titulli Master of Arts, në Co De Joint European Masteron Comparative Local Developments në Universitetin e Trentos, Itali. Ka kryer studimet e doktoraturës në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës në vitin 2013.

Përgjatë karrierës së tij, Z. Bejtja ka marrë pjesë dhe është kualifikuar në një sërë trajnimesh në institucione të ndryshme arsimore dhe profesionale në BE dhe në vend. Në periudhën shtator 2009 – maj 2013 ka qenë deputet i Parlamentit të Shqipërisë për Qarkun Elbasan.

Z. Bejtja ka qenë pedagog në Universitetin “Aleksandër Xhuvani” të Elbasanit nga viti 1998 e në vazhdim, me kohë të plotë e të pjesshme në lëndët e Marketingut.

Deri në vitin 2009 Z. Bejtja ka ushtruar funksione të ndryshme si Specialist Marketingu, Menaxhim dhe dizejm Projekti pranë “The Right Choice – Consultancy on Law and Economy” (2008 – 2009), Drejtor Ekzekutiv pranë “Market and Economical Research Institute” (2006 – 2007), Koordinator i Projektesh në Co-Plan Tirana, Institute for Habitat Development, Urban Research Institute (2004-2006), Koordinator Rajonal dhe Konsulent për Qarqet e Elbasanit, Korçës dhe Vlorës në “Institute on Surveys and Observations” (2003-2005), Doganier dhe Përgjegjës i Seksionit të Doganim-Zhdoganimeve në Elbasan (1991-1998).

Z. Bejtja është gjithashtu Kryetar i Këshillit Mbikëqyrës, FK Elbasani, që prej vitit 2003 dhe anëtar i Komisionit të Marketingut në ECA – European Club Association, UEFA në periudhën 2006-2009.

Nga tetor 2013 deri në shtator 2017 ka mbajtur postin e zv/ministrit të Energjisë dhe Industrisë. Aktualisht z. Ilir Bejtja është këshilltar i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë. Zotëron shumë mirë gjuhën angleze, italiane, maqedonase si dhe ka njohuri të spanjishtes, gjermanishtes dhe serbishtes.

Nënprefekti

Nënprefekti në mbështetje të ligjit emërohet dhe shkarkohet nga ministri i Brendshëm me propozim të Prefektit të Qarkut.

Në mbështetje të nenit 22 të ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, *nënprefekti për veprimtarinë e vet, për bashkinë/bashkitë përgjigjet drejtpërdrejt te prefekti i qarkut. Pranë nënprefektit funksionojnë zyrat e ankesave të qytetarëve.*

Niveli i pagës sipas pikës 6 të VKM-së nr. 187 datë 8.3. 2017 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit” e ndryshuar.

Nënprefekti Peqin

Z. Skender Hasa

Ka lindur në Peqin.

Ka përfunduar shkollën e mesme të përgjithshme në Peqin 1983-1987. Ka përfunduar akademinë ushtarake “Skënderbej” Tiranë 1988-1991.

Eksperiencia pune: 1991-1995 Oficer në Bazën e Furnizimit të Ushtrisë Tiranë.

Nga 1995-2001 Oficer i Policisë Gjyqësore pranë Prokurorisë Ushtarake Korçë.

Nga 2003-2007 ka qenë Kryetar i Bashkisë Peqin

Nga 2009-2013 Deputet i PS në Kuvendin e Shqipërisë.

Nga muaji korrik 2023 ushtron detyrën e Nënprefektit Peqin.

Nënprefekti Librazhd

Z. Josif Laska

Ka lindur në Roskovec, Fier, më 6 dhjetor të vitit 1960.

Ka përfunduar shkollën e mesme të përgjithshme në Librazhd në vitet 1976-1980. Nëntor 1983 deri nëntor 1984 ka kryer shkollën 1-vjecare ushtarake, dega Ndërlidhje. Studimet e larta i ka kryer në Universitetin Kristal, dega Menaxhim Bisnes dhe është diplomuar në vitin 2009.

Eksperiencia pune në sektorin publik: nga viti 1983-1995 ka punuar pranë Repartit Ushtarak nr.377 Librazhd, si specialist ndërlidhjeje. Nga viti 1999-2007 ka qenë punonjës policie pranë Komisarariatit Librazhd. Nga viti 2016- 2022 ka qenë kryetar i degës së Postës Librazhd.

Nga muaji Nëntor 2022 ushtron detyrën e Nënprefektit Librazhd.

Nënprefekti Gramsh

Z. Albert Ceci

Ka lindur në qytetin e Gramshit, më 24 Gusht 1968.

Ka përfunduar shkollën e mesme të përgjithshme “Shefqet Guzi” në Gramsh në vitet 1982-1986. Studimet e larta i ka kryer në Universitetin e Tiranës, Fakulteti I Shkencave të Natyrës, Dega Fizikë.

Eksperiencia pune në sektorin publik: Nga 1992-1998 ka qenë mësues fizike në shkollën e mesme të përgjithshme “Shefqet Guzi” dhe shkollën “Asllan Shahini”, Gramsh.

Nga 2000-2006, përgjegjës administrimi i konviktit të shkollës së mesme.

Nga 1998-2006 Nëndrejtor në shkollëm e mesme të përgjithshme “Shefqet Guzi”

Nga 2006-2014 mësues fizike pranë shkollës 9-vjecare “35-vjetori i Clirimit”

Nga 2014-2023 Drejtor i shkollës 9-vjecare “35-vjetori i Clirimit”

Nga muaji gusht 2023 ushtron detyrën e Nënprefektit Gramsh.

Nëpunësit e administratës janë pjesë e shërbimit civil ndaj për emërimin, marrjen e masave disiplinore, lirim nga detyra ndiqen procedurat e parashikuara në ligin 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar dhe aktet nënligjore të miratuara në zbatim të tij.

Niveli i pagave përcaktohet në bazë të VKM-së nr. 187 datë 8.3. 2017 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit” e ndryshuar. Përkatësisht pika 10/5 lidhja nr.7/5.